



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.24

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9487 datë 6.3.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”.....	723
Ligj nr.9488 datë 13.3.2006	Për ratifikimin e protokollit shtesë të Konventës Europiane “Për informimin për të drejtën e huaj”.....	724
Ligj nr.9490 datë 13.3.2006	Për ratifikimin e Konventës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris 2003.....	727
Ligj nr.9491 datë 13.3.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”, të ndryshuar...	738
Ligj nr.9493 datë 13.3.2006	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”.....	739
Ligj nr.9494 datë 13.3.2006	Për një ndryshim në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar.....	750

L I G J
Nr. 9487, datë 6.3.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9047, DATË 10.7.2003
“PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Fjala e dytë e pikës 1 të nenit 10 ndryshohet si më poshtë:
“Shtetasi shqiptar që ka përfunduar një shkollë të lartë universitare me shkëputje nga puna, brenda ose jashtë vendit, përjashtohet nga kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.”.

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) për rastet e fatkeqësive familjare dhe kur personat në ngarkim të ushtarit mbeten pa përkujdesje;”.
2. Pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” dhe “d” me këtë përmbajtje:
“ç) shtetasi kryefamiljar, i cili gjatë kohës së kryerjes së shërbimit ushtarak bëhet me dy ose më shumë fëmijë;
d) titullohet ushtar profesionist.”.
3. Në paragrafin e fundit shprehja “shkronjave “a”, “b” dhe “c”” bëhet “shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d””.

Neni 3

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Detyrimet e organeve të Policisë së Shtetit

Organet e Policisë së Shtetit në qarqe detyrohen të shoqërojnë për në qendrën e rekrutim-mobilizimit të qarkut shtetasit, të cilët janë thirrur për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas listëthirrjeve të dërguara nga qendra e rekrutim-mobilizimit dhe që nuk janë paraqitur në qendrën e rekrutim-mobilizimit.

Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Brendshëm nxjerrin udhëzime të përbashkët për zbatimin e këtij neni.”.

Neni 4

Në pikën 3 të nenit 40, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Vendimi i komisionit është titull ekzekutiv.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4815, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr. 9488, datë 13.3.2006

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË TË KONVENTËS EUROPIANE “PËR
INFORMIMIN PËR TË DREJTËN E HUAJ”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet protokollin shtesë i Konventës Europiane “Për informimin për të drejtën e huaj”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4816, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

PROTOKOLL SHITESË
I KONVENTËS EUROPIANE PËR INFORMIMIN MBI TË DREJTËN E HUAJ

Strasburg, më 15.2.1978

Shtetet nënshkruese, anëtare të Këshillit të Europës,

duke pasur parasysh dispozitat e Konventës Europiane për Informimin mbi të drejtën e huaj, të hapur për nënshkrim në Londër, më 7 qershor 1968 (këtu e më poshtë, referuar si “Konventa”);

duke konsideruar se është e dëshirueshme të zgjerohet sistemi i ndihmës së ndërsjellë ndërkombëtare të iniciuar nga kjo Konventë në fushën e të drejtës dhe procedurës penale, në një kuadër shumëpalësh, të hapur për të gjitha Palët Kontraktuese të Konventës;

duke marrë në konsideratë qëllimin e eliminimit të barrierave ekonomike ndaj procedimeve ligjore dhe lejimin e personave në një pozicion ekonomik të dobët të ushtrojnë lehtësisht të drejtat e tyre në shtetet anëtare, është e dëshirueshme të shtrihet sistemi i krijuar nga Konventa në fushën e ndihmës dhe këshillimit ligjor në çështjet civile dhe tregtare;

duke vërejtur se neni 1 paragrafi 2 i Konventës parashikon se dy ose më shumë Palë Kontraktuese mund të vendosin të zgjerojnë midis tyre fushën e veprimit të Konventës në fusha të tjera nga ato të referuara në këtë Konventë;

duke vërejtur se neni 3 paragrafi 3 i Konventës parashikon se dy ose më shumë Palë Kontraktuese mund të vendosin të shtrijnë midis tyre fushën e veprimit të Konventës për kërkesa prej autoriteteve të tjera të ndryshme nga autoritetet gjyqësore;
kanë rënë dakord sa më poshtë:

KAPITULLI I

Neni 1

Palët Kontraktuese marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës, në përputhje me dispozitat e Konventës, informacion mbi të drejtën e tyre materiale dhe procedurale dhe organizimin gjyqësor në fushën penale, duke përfshirë autoritetet e ndjekjes penale, si dhe në lidhje me zbatimin e masave penale. Kjo sipërmarrje zbatohet për të gjitha procedimet në lidhje me veprat penale, ndjekja penale e të cilave, në kohën e kërkesës për informacion, hyn në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese.

Neni 2

Një kërkesë për informacion mbi çështjet në fushën e referuar në nenin 1, mund:

- a) të nxirret jo vetëm nga një gjykatë, por edhe nga autoritetet gjyqësore që ka juridiksion për të ndjekur penalisht veprat penale ose që ekzekuton dënimet e formës së prerë;
- b) të bëhet jo vetëm kur janë filluar procedimet, por edhe kur është parashikuar fillimi i këtyre procedimeve.

KAPITULLI II

Neni 3

Brenda kuadrit të angazhimit në përmbajtje të nenit 1, paragrafi 1 i Konventës, Palët Kontraktuese bien dakord që kërkesat për informacion mund:

- a) të nxirren jo vetëm nga autoriteti gjyqësor, por edhe nga çdo autoritet apo person që vepron brenda sistemeve zyrtare të ndihmës ose këshillimit ligjor në emër të personave në një pozicion ekonomik të dobët;
- b) të bëhen jo vetëm kur procedimet kanë filluar, por edhe kur është parashikuar fillimi i procedimeve.

Neni 4

1. Çdo Palë Kontraktuese, e cila nuk ka krijuar apo caktuar një ose më shumë organe për të vepruar si agjenci transmetuese siç parashikohet në nenin 2 paragrafi 2 i Konventës, do të krijojë ose caktojë këtë apo këto agjenci për qëllime të transmetimit të çdo kërkesë për informacion, në përputhje me nenin 3 të këtij protokollit ndaj agjencisë kompetente të huaj marrëse.

2. Çdo Palë Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresën e agjencisë ose agjencive transmetuese të krijuara ose caktuara në përputhje me paragrafin e mësipërm.

KAPITULLI III

Neni 5

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë që do t'i përmbahet vetëm njërit prej kapitujve I dhe II të këtij protokollit.

2. Çdo shtet pasi ka bërë këtë deklaratë, në një kohë të mëvonshme, mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do t'i përmbahet dispozitave të kapitullit I dhe II. Ky njoftim do të ketë efekt nga data e marrjes së tij.

3. Çdo Palë Kontraktuese e cila i përmbahet dispozitave të kapitullit I dhe II mundet, në çdo kohë, të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do t'i përmbahet vetëm njërit prej kapitujve I dhe II. Ky njoftim do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

4. Dispozitat e kapitullit I dhe II, sipas rastit, do të zbatohen vetëm midis Palëve Kontraktuese, të cilat i përmbahen kapitullit në fjalë.

Neni 6

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente, që mund të bëhen palë të saj me anë të:

a) nënshkrimit pa rezervë në lidhje me ratifikimin, aderimin ose miratimin;
b) nënshkrimit me rezervë në lidhje me ratifikimin, aderimin ose miratimin, pasuar nga ratifikimi, aderimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, aderimit ose i miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund ta nënshkruajë këtë protokoll pa rezervë, në lidhje me ratifikimin, aderimin ose miratimin, as ta ratifikojë, aderojë ose miratojë atë, për sa kohë që nuk ka ratifikuar ose aderuar në Konventë në të njëjtën kohë ose në një kohë të mëparshme.

Neni 7

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Europës do të jenë bërë palë të protokollit në përputhje me dispozitat e nenit 6.

2. Në rast se ndonjë shtet anëtar që do të nënshkruajë në një kohë të mëvonshme protokollin pa rezervë në lidhje me ratifikimin, aderimin ose miratimin ose që do ta ratifikojë, aderojë apo miratojë atë, protokollin do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së këtij nënshkrimi ose pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 8

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit, çdo shtet, i cili ka aderuar ose që është ftuar të aderojë në Konventë, mund të ftohet nga Komiteti i Ministrave të aderojë në këtë protokoll.

2. Ky aderim do të bëhet me anë të depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi që do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 9

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të specifikojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet ky protokoll.

2. Çdo shtet, me depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose në një datë të mëvonshme, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë fushën e veprimit të këtij protokollit në ndonjë territor ose territore të tjera të specifikuar në deklaratë dhe është përgjegjës për ato marrëdhënie ndërkombëtare ku ose në emër të të cilave është i autorizuar të ndërmarrë angazhime.

3. Çdo deklaratë e bërë në zbatim të paragrafit të mësipërm, në lidhje me ndonjë territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo tërheqje do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 10

1. Çdo Shtet Palë, në masën që është i interesuar, mund ta denoncojë këtë protokoll me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

3. Denoncimi i Konventës do të kërkojë automatikisht denoncimin e këtij protokoll.

Neni 11

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet që ka aderuar në Konventë në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin;
- b) çdo nënshkrim me rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin;
- c) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- d) çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll, në përputhje me nenin 7;
- e) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 4;
- f) çdo deklaratë ose njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 5;
- g) çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 9 dhe çdo tërheqje të kësaj deklaratë;
- h) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 10 dhe datën në të cilën denoncimi ka efekt.

Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajë këtë protokoll.

Bërë në Strasburg, më 15 mars 1978, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të transmetojë kopje të vërtetuara të secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

L I G J

Nr. 9490, datë 13.3.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE, PARIS 2003

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4818, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

KONVENTA
PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE

Paris, më 17 tetor 2003

Konferenca e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsimin shkencën dhe kulturën, më poshtë e quajtur “UNESCO”, e mbledhur në Paris nga 29 shtatori deri në 17 tetor 2003 në sesionin e 32-të të saj,

duke iu referuar instrumenteve ndërkombëtare ekzistuese lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti Deklaratës së përbotshme për të drejtat e njeriut të 1948-ës, Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 1966-ës dhe Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të 1966-ës;

duke marrë parasysh rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përmbledhëse e diversitetit kulturor dhe garanci e zhvillimit afatgjatë, siç theksohet në Rekomandimin e UNESCO-s për mbrojtjen e kulturës tradicionale dhe popullore të 1989-s, në Deklaratën e përbotshme të UNESCO-s për diversitetin kulturor të vitit 2001 dhe në Deklaratën e Stambollit të vitit 2002 miratuar në Tryezën e Tretë të Rrumbullakët të ministrave të kulturës;

duke marrë parasysh ndërvarësinë midis trashëgimisë kulturore jomateriale dhe trashëgimisë materiale kulturore dhe natyrore;

duke pranuar se proceset e mondializimit dhe të ndryshimit shoqëror, krahas kushteve që krijojnë për një dialog të përtërirë mes bashkësive, shkaktojnë gjithashtu, njësoj si dhe dukuritë e mostolerancës, kërcënime të rënda për degradim, për zhdukje dhe shkatërrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, veçanërisht për faktin e mungesës së mjeteve për ruajtjen e kësaj të fundit;

e ndërgjegjshme për vullnetin e përbotshëm dhe për shqetësimin e përbashkët për të ruajtur trashëgiminë kulturore jomateriale të njerëzimit;

duke pranuar se bashkësitë, në veçanti bashkësitë rrënjëse, grupet dhe, sipas rastit, individët, luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, duke ndihmuar kështu për pasurimin e diversitetit kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore;

duke shënuar shtrirjen e madhe të veprimtarisë së kryer nga UNESCO-ja për të ndërtuar instrumentet normative për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht Konventën për mbrojtjen e trashëgimisë botërore, kulturore dhe natyrore të vitit 1972;

duke shënuar gjithashtu se deri tani nuk ka asnjë instrument shumëpalësh me karakter shtrëngues që të synojë ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale;

duke pasur parasysh se marrëveshjet, rekomandimet dhe rezolutat ndërkombëtare që ekzistojnë lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore do të duhej të pasuroheshin dhe të plotësoheshin në mënyrë të frytshme me anë të dispozitave të reja lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale;

duke pasur parasysh detyrimin e bashkësisë ndërkombëtare për të dhënë ndihmesën me shtetet palë në këtë Konventë për ruajtjen e kësaj trashëgimie në një frymë bashkëpunimi dhe ndihme të ndërsjellë;

duke sjellë në vëmendje programet e UNESCO-s lidhur me trashëgiminë kulturore jomateriale, sidomos shpalljen e kryeveprave të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit,

duke pasur parasysh rolin e paçmueshëm të trashëgiminë kulturore jomateriale si faktor afrimi, shkëmbimesh dhe kuptimi midis qenieve njerëzore,
miraton këtë Konventë më 17 tetor 2003.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimet e Konventës

Qëllimet e kësaj Konvente janë:

- a) ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- b) respektimi i trashëgimisë kulturore jomateriale të bashkësive, të grupeve dhe të individëve të prekur;
- c) sensibilizimi në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për rëndësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale dhe të vlerësimit të saj të ndërsjellë;
- d) bashkëpunimi dhe asistenca ndërkombëtare.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. Me “trashëgimi kulturore jomateriale” kuptohen praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë dhe dijeberja (*savoir-faire*)-si dhe veglat, objektet, artifaktet dhe hapësirat kulturore që bashkëshoqërojnë ato – që bashkësitë, grupet dhe, kur është rasti, individët i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, përcjellë brez pas brezi, është rikrijuar në vijimësi nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke ndihmuar kështu për nxitjen e respektit për diversitetin kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Për qëllimet e kësaj Konvente, do të merret parasysh vetëm trashëgimia kulturore jomateriale në përputhje me instrumentet ndërkombëtare ekzistuese lidhur me të drejtat e njeriut, si dhe me kërkesën për respektim të ndërsjellë ndërmjet bashkësive, grupeve dhe individëve, dhe me një zhvillim afatgjatë.

2. “Trashëgimia kulturore jomateriale”, siç është përcaktuar në paragrafin 1 më sipër, shfaqet sidomos në fushat e mëposhtme:

- a) traditat dhe shprehjet gojore, përfshirë këtu edhe gjuhën si vektor i trashëgimisë kulturore jomateriale;
- b) artet e shfaqjes (spektaklit);
- c) praktikat sociale, ritualet dhe ngjarjet festive;
- d) njohjet dhe praktikat lidhur me natyrën dhe gjithësinë;
- e) dijeberja lidhur me artizanatin tradicional.

3. Me “ruajtje” kuptohen masat që synojnë jetëgjatësinë e trashëgimisë kulturore jomateriale, përfshirë këtu identifikimin, dokumentimin, kërkimin, ruajtjen, mbrojtjen, nxitjen, vlerësimin, përcjelljen, kryesisht përmes edukimit formal dhe joformal, si dhe rigjallërimin e aspekteve të ndryshme të kësaj trashëgimie.

4. Me “shtete palë” kuptohen shtetet që janë të lidhur nga kjo Konventë dhe midis të cilëve kjo është në fuqi.

5. Kjo Konventë zbatohet *mutatis mutandis* në territoret e parashikuara në nenin 33 që bëhen palë në të, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen. Kështu, shprehja “shtete palë” kuptohet edhe për këto territore.

Neni 3

Lidhja me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet si:

- a) ndryshim i statusit apo ulje e nivelit të mbrojtjes së pasurive të deklaruara të trashëgimisë botërore në kuadrin e Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore të vitit 1972, me të cilën një element i trashëgimisë kulturore jomateriale është i lidhur drejtpërdrejt; ose
- b) prekje e të drejtave dhe detyrimeve të shteteve palë që rrjedhin nga çdo instrument ndërkombëtar mbi të drejtat e pronësisë intelektuale ose me përdorimin e burimeve biologjike dhe ekologjike ku ata janë palë.

II. ORGANET E KONVENTËS

Neni 4

Asambleja e përgjithshme e shteteve palë

Është ngritur një asamble e përgjithshme e shteteve palë, më poshtë e quajtur “Asamble e përgjithshme”. Asambleja e përgjithshme është organi sovran i kësaj Konvente.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në sesion të zakonshëm çdo dy vjet. Ajo mund të mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm nëse ajo vendos kështu ose nëse asaj i është drejtuar kërkesë nga Komiteti ndërqeveritar i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale ose nga jo më pak se një e treta e shteteve palë.

Asambleja e përgjithshme miraton rregulloren e saj të brendshme.

Neni 5

Komiteti ndërqeveritar i ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale

1. Pranë UNESCO-s është ngritur një Komitet ndërqeveritar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, më poshtë i quajtur “Komiteti”. Ai përbëhet nga përfaqësues të 18 shteteve palë, të zgjedhur nga shtetet palë mbledhur në asamblenë e përgjithshme me të hyrë në fuqi kjo Konventë, në përputhje me nenin 34.

2. Numri i shteteve anëtare të Komitetit do të bëhet 24 me të arritur 50 numri i shteteve palë në këtë Konventë.

Neni 6

Zgjedhja dhe mandati i shteteve anëtare të Komitetit

1. Zgjedhja e shteteve anëtare të Komitetit duhet të respektojë parimet e shpërndarjes gjeografike dhe të rotacionit të rregullt.

2. Shtetet anëtare të Komitetit zgjidhen për një mandat katërvjeçar nga shtetet palë në Konventë të mbledhur në asamble të përgjithshme.

3. Megjithatë, mandati i gjysmës së shteteve anëtare të Komitetit të zgjedhura gjatë zgjedhjes së parë kufizohet në dy vjet. Këto shtete përcaktohen me një short të hedhur gjatë kësaj zgjedhjeje të parë.

4. Çdo dy vjet asambleja e përgjithshme bën përtëritjen e gjysmës së shteteve anëtare të Komitetit.

5. Gjithashtu ajo zgjedh atë shtete anëtare të Komitetit sa nevojiten për të plotësuar vendet e lira.

6. Një shtet anëtar i Komitetit nuk mund të zgjidhet për dy mandate të njëpasnjëshme.

7. Shtetet anëtare të Komitetit zgjedhin për t'i përfaqësuar persona të kualifikuar në fushat e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale.

Neni 7

Funksionet e Komitetit

Pa cenuar atributet e tjera që i janë dhënë nga kjo Konventë, funksionet e Komitetit janë si më poshtë:

a) promovimi i objektivave të Konventës, nxitja dhe garantimi i vijimësisë për zbatimin e saj;

b) dhënia e këshillave për praktikat më të mira dhe formulimi i rekomandimeve për masat në favor të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) përgatitja dhe paraqitja për miratim në asamblenë e përgjithshme e një projekti për përdorimin e burimeve të Fondit, në përputhje me nenin 25;

d) përpjekja për të gjetur mjetet për shtimin e burimeve të tij dhe marrja e masave të nevojshme për këtë qëllim, në përputhje me nenin 25;

e) përgatitja dhe paraqitja për miratim në asamblenë e përgjithshme e direktivave operacionale për zbatimin e Konventës;

f) shqyrtimi, në përputhje me nenin 29 i raporteve të shteteve palë, dhe bërja e një përmbledhjeje për këtë për t'ia paraqitur asamblesë së përgjithshme;

g) shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga shtetet palë dhe vendimmarrja, në përputhje me kriteret objektive të përzgjedhjes të vendosura prej tij dhe të miratuara nga asambleja e përgjithshme për:

i) regjistrimin në lista të propozimeve të përmendura në nenet 16, 17 dhe 18;

ii) dhënien e mbështetjes ndërkombëtare në përputhje me nenin 22.

Neni 8

Metoda të punës së Komitetit

1. Komiteti përgjigjet përpara asamblesë së përgjithshme. Ai jep llogari për të gjitha veprimtaritë dhe vendimet.

2. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij.

3. Komiteti mund të krijojë përkohësisht organe këshillimore *ad-hoc* të cilat i gjykon të nevojshme për zbatimin e detyrave të tij.

4. Komiteti mund të ftojë në mbledhjet e tij organizma publikë ose privatë, si dhe persona fizikë, që kanë kompetencë të mirënjohur në fusha të ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale, për t'u këshilluar me ta për çështje të veçanta.

Neni 9

Akreditimi i organizatave këshillimore

1. Komiteti i propozon asamblesë së përgjithshme akreditimin e organizatave joqeveritare që kanë kompetencë të mirënjohur në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale. Këto organizata do të kenë funksione këshillimore pranë Komitetit.

2. Komiteti i propozon gjithashtu asamblesë së përgjithshme kriteret dhe modalitetet e këtij akreditimi.

Neni 10

Sekretariati

1. Komiteti mbështetet nga Sekretariati i UNESCO-s.

2. Sekretariati përgatit dokumentacionin e asamblesë së përgjithshme dhe të Komitetit, si dhe projektrendin e ditës së mbledhjeve të tyre dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre.

III. RUAJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE NË SHKALLË KOMBËTARE

Neni 11

Roli i shteteve palë

I përket çdo shteti palë:

a) të marrë masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij;

b) të ndërmarrë masat e ruajtjes, të parashikuara në nenin 2 paragrafi 3, për të identifikuar dhe përcaktuar elementet e ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij, me pjesëmarrjen e bashkësive, të grupeve dhe të organizatave joqeveritare përkatëse.

Neni 12

Inventarët

1. Për të siguruar identifikimin me synim ruajtjen, çdo shtet palë, në përputhje me gjendjen e tij, harton një ose shumë inventarë të trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij. Këta inventarë janë objekt i një përditësimi të rregullt.

2. Çdo shtet palë, kur i paraqit periodikisht raportin Komitetit, në përputhje me nenin 29, jep informacionin përkatës lidhur me këta inventarë.

Neni 13

Masa të tjera ruajtjeje

Me qëllim që të sigurohet ruajtja, zhvillimi dhe vënia në pah e trashëgimisë kulturore jomateriale, e pranishme në territorin e tij, çdo shtet palë përpiket:

a) të hartojë një politikë të përgjithshme, që të synojë vënien në pah të funksionit të trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri dhe të integrojë ruajtjen e kësaj trashëgimie në programe planifikimi;

b) të caktojë ose të ngrrejë një ose disa organizma kompetentë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishëm në territorin e tij;

c) të nxisë studime shkencore, teknike dhe artistike, si dhe metodologji kërkimore për një ruajtje të efektshme të trashëgimisë kulturore jomateriale, në veçanti të trashëgimisë kulturore jomateriale në rrezik;

d) të miratojë masat ligjore, teknike, administrative dhe financiare përkatëse me synim:

i) favorizimin e krijimit ose të forcimit të institucioneve për formim në administrim të trashëgimisë kulturore jomateriale, si dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie përmes forumeve dhe hapësirave të destinuara për paraqitjen dhe shprehjen e saj;

ii) garantimin e shfrytëzimit të trashëgimisë kulturore jomateriale gjithnjë duke respektuar praktikat zakonore që rregullojnë shfrytëzimin në disa aspekte specifike të kësaj trashëgimie;

iii) ngritjen e institucioneve dokumentare për trashëgiminë kulturore jomateriale dhe mundësimin e shfrytëzimit të tyre.

Neni 14

Edukimi, sensibilizimi dhe rritja e kapaciteteve

Çdo shtet palë përpiket me të gjitha mjetet përkatëse:

a) të sigurojë njohjen, respektimin dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore jomateriale në shoqëri, veçanërisht me:

i) programe edukative, sensibilizuese dhe përhapëse të informacionit për publikun, sidomos për të rinjtë;

ii) programe të posaçme për edukim dhe formim brenda bashkësive dhe grupeve të interesuara;

iii) veprimtari për forcimin e kapaciteteve në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale dhe në veçanti për administrimin dhe kërkimin shkencor; dhe

iv) mjete joformale të përcjelljes së dijeve.

b) të mbajë publikun të informuar për kërcënimet që rëndojnë mbi këtë trashëgimi, si dhe për veprimtaritë e kryera për të zbatuar këtë Konventë;

c) të promovojë edukimin për mbrojtjen e hapësirave natyrore dhe të vendeve historike, ekzistenca e të cilëve është e nevojshme për shprehjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Neni 15

Pjesëmarrje e bashkësive, grupeve dhe individëve

Në kuadrin e veprimtarive të tij për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, çdo shtet palë përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen më të madhe të mundshme të bashkësive, të grupeve dhe, sipas rastit, të individëve që krijojnë, mirëmbajnë dhe përcjellin këtë trashëgimi dhe t'i përfshijnë gjallërisht në administrimin e saj.

IV. RUAJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE NË SHKALLË NDËRKOMBËTARE

Neni 16

Lista paraqitëse e trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit

1. Për të siguruar një shikueshmëri më të mirë të trashëgimisë kulturore jomateriale, një ndërgjegjësim më të mirë të rëndësisë së saj, si dhe për të favorizuar dialogun duke respektuar diversitetin kulturor, Komiteti, me propozim të shteteve palë të interesuara, harton, përditëson dhe publikon një listë paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit.

2. Komiteti harton dhe i paraqet për miratim asamblesë së përgjithshme kriteret kryesore për hartimin, përditësimin dhe publikimin e kësaj liste paraqitëse.

Neni 17

Lista e trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë të ngutshme për ruajtje

1. Për të marrë masat përkatëse për ruajtje, Komiteti harton, përditëson dhe publikon një listë të trashëgimisë kulturore jomateriale, që ka nevojë të ngutshme për ruajtje, dhe e regjistron këtë trashëgimi në listën e kërkuar nga shteti palë i interesuar.

2. Komiteti harton dhe i paraqet për miratim asamblesë së përgjithshme kriteret kryesore për hartimin, përditësimin dhe publikimin e kësaj liste.

3. Në rast të një ngutshmërie të skajshme – për të cilën kriteret objektive janë miratuar nga asambleja e përgjithshme me propozim të Komitetit – ky i fundit mund të regjistrojë një element të trashëgimisë në fjalë në listën e përmendur në paragrafin 1 duke u këshilluar me shtetin palë të interesuar.

Neni 18

Programe, projekte dhe veprimtari për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale

1. Në bazë të propozimeve të paraqitura nga shtetet palë dhe në përputhje me kriteret që ai përcakton dhe që janë miratuar nga Asambleja e përgjithshme, Komiteti përzgjedh periodikisht dhe promovon programe, projekte dhe veprimtari me karakter kombëtar, nënrajonal ose rajonal për ruajtjen e trashëgimisë që ai i gjykon se pasqyrojnë më mirë parimet dhe objektivat e kësaj Konvente, duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim.

2. Për këtë qëllim ai merr, shqyrton dhe miraton kërkesat për mbështetje ndërkombëtare të formuluar nga shtetet palë për hartimin e këtyre propozimeve.

3. Komiteti e shoqëron zbatimin e këtyre programeve, projekteve dhe veprimtarive me përhapjen e praktikave më të mira sipas modaliteteve të paracaktuara prej tij.

V. BASHKËPUNIMI DHE MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

Neni 19

Bashkëpunimi

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, bashkëpunimi ndërkombëtar përfshin në veçanti shkëmbimin e informacioneve dhe të përvojave, të nismave të përbashkëta, si dhe ngritjen e një mekanizmi për të mbështetur shtetet palë në përpjekjet e tyre për të ruajtur trashëgiminë kulturore jomateriale.

2. Pa cenuar dispozitat e legjislacionit të tyre kombëtar dhe të të drejtave dhe praktikave zakonore të tyre, shtetet palë pranojnë që ruajtja e trashëgimisë kulturore jomateriale është në interesin e përgjithshëm të njerëzimit dhe zotohen, për këtë qëllim, të bashkëpunojnë në nivelet dypalëshe, nënrajonale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Neni 20

Objektivat e mbështetjes ndërkombëtare

Mbështetja ndërkombëtare mund të jepet për objektivat e mëposhtëm:

- a) Ruajtje e trashëgimisë së regjistruar në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale që ka nevojë për ruajtje të ngutshme;
- b) Përgatitje e inventarëve në kuptimin e neneve 11 dhe 12;
- c) Mbështetje për programet, projektet dhe veprimtaritë e orientuara në nivel kombëtar, nënrajonar dhe rajonal, që synojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale;
- d) Çdo objektiv tjetër që Komiteti do ta gjykonte të nevojshëm.

Neni 21

Forma të mbështetjes ndërkombëtare

Mbështetja e dhënë nga Komiteti për një shtet palë rregullohet me direktiva operacionale të parashikuar në nenin 7 dhe nga marrëveshja e përcaktuar në nenin 24, dhe mund të marrë format e mëposhtme:

- a) Studime lidhur me aspekte të ndryshme të ruajtjes;
- b) Vënie në dispozicion e ekspertëve dhe zbatuesve;
- c) Formimi i gjithë personelit të nevojshëm;
- d) Hartimi i masave normative ose të tjera;
- e) Krijimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturave;
- f) Furnizimi me pajisje dhe me dijebërje (*savoir-faire*);
- g) Forma të tjera mbështetjeje financiare dhe teknike, përfshirë aty, sipas rastit, dhënien e kredive me interes të ulët dhe donacione.

Neni 22

Kushtet për mbështetje ndërkombëtare

1. Komiteti harton procedurën e shqyrtimit të kërkesave për mbështetje ndërkombëtare dhe përcakton elementet e kërkesës, siç janë masat e parashikuara, ndërhyrjet e nevojshme dhe vlerësimi i kostos së tyre.

2. Në rast urgjence, kërkesa për mbështetje duhet të shqyrtohet me përparësi nga Komiteti.

3. Me qëllim që të merret një vendim, Komiteti bën studimet dhe këshillimet që ai i gjykon të nevojshme.

Neni 23

Kërkesat për mbështetje ndërkombëtare

1. Çdo shtet palë mund t'i paraqesë Komitetit një kërkesë për mbështetje ndërkombëtare për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale të pranishme në territorin e tij.
2. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet bashkërisht edhe nga dy ose më shumë shtete palë.
3. Kërkesa duhet të përmbajë elementet e informacionit, parashikuar në nenin 22 paragrafi 1, dhe dokumentet e nevojshme.

Neni 24

Roli i shteteve palë përfituese

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mbështetja ndërkombëtare e dhënë rregullohet me një marrëveshje ndërmjet shtetit palë përfitues dhe Komitetit.
2. Si rregull i përgjithshëm shteti palë përfitues duhet të marrë pjesë, brenda mundësive të tij, në koston e masave ruajtëse për të cilat është dhënë një mbështetje ndërkombëtare.
3. Shteti palë përfitues i paraqet Komitetit një raport për përdorimin e mbështetjes së dhënë në favor të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale.

VI. FONDI I TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE

Neni 25

Natyra dhe burimet e Fondit

1. Është krijuar një “Fond për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale”, më poshtë i quajtur “Fondi”.
2. Fondi përbëhet nga fondi i depozituar në përputhje me dispozitat e rregullores financiare të UNESCO-s.
3. Burimet e fondit përbëhen nga:
 - a) kontributet e shteteve palë;
 - b) fondet e dhëna për këtë qëllim nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s;
 - c) derdhjet, dhurimet dhe lëniet në trashëgim që mund të bëjnë:
 - i) shtetet e tjera;
 - ii) organizatat dhe programet e sistemit të Kombeve të Bashkuara, sidomos programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillimin, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare;
 - iii) Organizma publikë ose privatë ose persona privatë;
 - d) çdo interes që duhet të kalojë në burimet e Fondit;
 - e) fondet e mbledhura prej të ardhurave nga manifestimet e organizuara në dobi të këtij Fondi;
 - f) të gjitha burimet e tjera të autorizuara nga rregullorja e Fondit të hartuar nga Komiteti.
4. Përdorimi i burimeve nga Komiteti përcaktohet në bazë të orientimeve të asamblesë së përgjithshme.
5. Komiteti mund të pranojë kontribute dhe forma të tjera mbështetjeje të dhëna për qëllime të përgjithshme ose të veçanta në lidhje me projekte të përcaktuara, me kusht që këto projekte të jenë miratuar nga Komiteti.
6. Kontributet në Fond nuk mund të shoqërohen me asnjë kusht politik, ekonomik a tjetër në mospërputhje me objektivat e përcaktuar nga kjo Konventë.

Neni 26

Kontribute të shteteve palë në Fond

1. Pa cenuar asnjë kontribut vullnetar shtesë, shtetet palë në këtë Konventë zotohen të derdhin në Fond, së paku çdo dy vjet, një kontribut, shuma e të cilit, e përlllogaritur sipas një përqindjeje uniforme e zbatueshme për të gjitha shtetet, do të vendoset nga asambleja e përgjithshme. Ky vendim i asamblesë së përgjithshme do të merret me shumicën e shteteve palë të pranishme dhe që votojnë, të cilat nuk e kanë bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni. Në asnjë rast, ky kontribut nuk mund të tejkalojë një për qind të kontributit të shtetit palë në buxhetin e zakonshëm të UNESCO-s.

2. Megjithatë, çdo shtet i parashikuar në nenin 32 ose në nenin 33 të kësaj Konvente, në çastin e depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, mund të deklarojë që ai nuk do të jetë i lidhur me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Një shtet palë i kësaj Konvente, që ka bërë deklaratën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, do të përpiqet të tërheqë të ashtuquajturën deklaratë duke venë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s. Sidoqoftë, tërheqja e deklaratës do të veprojë për kontributin që duhet të japë ky shtet vetëm pas datës së hapjes së sesionit pasardhës të asamblesë së përgjithshme.

4. Me qëllim që Komiteti të ketë mundësi të parashikojë operacionet e veta në mënyrë të efektshme, kontributet e shteteve palë në këtë Konventë, që kanë bërë deklaratën e parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të derdhen rregullisht të paktën çdo dy vjet dhe do të duhej të afroreshin mundësisht sa më shumë me kontributet që do të ishte dashur të derdhnin ata nëse do të kishin qenë të lidhur me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

5. Çdo shtet palë në këtë Konventë, i vonuar në pagesën e kontributit të tij të detyrueshëm ose vullnetar për vitin në vijim dhe të vitit kalendarik paraardhës, nuk është i zgjedhshëm në Komitet, por kjo dispozitë nuk është e zbatueshme gjatë zgjedhjes së parë. Mandati i një shteti të tillë, që është tashmë anëtar i Komitetit, do të përfundojë në çastin e çdo zgjedhjeje të parashikuar në nenin 6 të kësaj Konvente.

Neni 27

Kontribute vullnetare shtesë në Fond

Shtetet palë që dëshirojnë të derdhin kontribute vullnetare përveç atyre të parashikuara në nenin 26, informojnë për këtë Komitetin sa më shpejt që të jetë e mundshme, me qëllim që, si pasojë, ky të ketë mundësi të planifikojë veprimtaritë e tij.

Neni 28

Fushata ndërkombëtare për grumbullim fondesh

Shtetet palë, brenda mundësive, japin ndihmesën e tyre në fushatat ndërkombëtare për grumbullim, të organizuara në dobi të Fondit nën kujdesin e UNESCO-s.

VII. RAPORTE

Neni 29

Raportet e shteteve palë

Shtetet palë i paraqesin Komitetit, në format dhe sipas periodikut të përcaktuar nga ky i fundit, raporte për dispozitat ligjore, rregulluese e të tjera të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 30
Raportet e Komitetit

Mbështetur në veprimtaritë e tij dhe në raportet e shteteve palë të përmendura në nenin 29, Komiteti paraqet një raport në çdo sesion të asamblesë së përgjithshme.

2. Ky raport i bëhet i ditur Konferencës së Përgjithshme të UNESCO-s.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE

Neni 31
**Marrëdhënia me shpalljen e kryeveprave
të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit**

1. Komiteti përfshin në listën paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit elementet e shpallura "Kryevepra të trashëgimisë gojore dhe jomateriale të njerëzimit" para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Përfshirja e këtyre elementeve në listën paraqitëse të trashëgimisë kulturore jomateriale të njerëzimit nuk paragjykon aspak kriteret e përcaktuara në përputhje me nenin 16 paragrafi 2 për regjistrimet e ardhshme.

3. Asnjë shpallje tjetër nuk do të bëhet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32
Ratifikimi, pranimi ose miratimi

1. Kjo Konventë i është nënshtuar ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare të UNESCO-s në përputhje me procedurat e tyre kushtetuese përkatëse.

2. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

Neni 33
Aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për të aderuar çdo shtet joanëtar i UNESCO-s i ftuar për të aderuar në të nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës.

2. Kjo Konventë është gjithashtu e hapur për të aderuar territoret që gëzojnë një autonomi të brendshme të plotë, të njohur si të tillë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, por që nuk kanë arritur në pavarësinë e plotë në përputhje me Rezolutën nr.1514 (XV) të asamblesë së përgjithshme dhe që janë kompetente për fushën që trajton kjo Konventë, përfshirë këtu kompetencën e njohur për të përfunduar traktate në këtë fushë.

3. Instrumenti i aderimit do të depozitohet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tridhjetë të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, por vetëm për shtetet që do të kenë depozituar instrumentet e tyre përkatëse të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë datë ose më parë. Ajo do të hyjë në fuqi për çdo shtet tjetër palë tre muaj pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 35

Regjimet kushtetuese federative ose jo të njësuara

Dispozitat e mëposhtme zbatohen për shtetet palë që kanë një regjim kushtetues federativ ose jounitar:

a) lidhur me dispozitat e kësaj Konvente, zbatimi i të cilave është kompetencë e pushtetit legjislativ federal ose qendror, detyrimet e qeverisë federale ose qendrore do të jenë të njëjta me ato të shteteve palë që nuk janë shtete federative;

b) lidhur me dispozitat e kësaj Konvente, e zbatimi i të cilave është kompetencë e secilit shtet, vend, provincë ose kanton përbërës, që në bazë të regjimit kushtetues të federatës nuk kanë detyrë të marrin masa legjislative, qeveria federale do t'ua përcjellë rekomandimet për miratim për këto dispozita autoriteteve kompetente të shteteve, vendeve, provincave ose kantoneve.

Neni 36

Denoncimi

1. Secili nga shtetet palë ka mundësinë ta denoncojë këtë Konventë.

2. Denoncimi bëhet i ditur me anë të një instrumenti të shkruar, të depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

3. Denoncimi bëhet i efektshëm dymbëdhjetë muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit. Ai nuk ndryshon detyrimet financiare të cilat shteti palë denoncues është i detyruar të shlyejë deri në datën kur tërheqja bëhet e efektshme.

Neni 37

Funksionet e ruajtësit

Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, me cilësinë e depozitarit të kësaj Konvente, informon shtetet anëtare të Organizatës, shtetet joanëtare të parashikuara në nenin 33, si dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara për depozitim të të gjitha instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të përmendura në nenet 32 dhe 33, si dhe të denoncimeve të parashikuara në nenin 36.

Neni 38

Amendimet

1. Çdo shtet palë, me anë të komunikimit me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të propozojë amendime për këtë Konventë. Drejtori i Përgjithshëm ua përcjell këtë komunikim të gjitha shteteve palë. Nëse, në gjashtë muajt pasardhës nga data e përcjelljes së komunikimit, së paku gjysma e shteteve palë jep një përgjigje pozitive për këtë kërkesë, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në sesionin e ardhshëm të asamblesë së përgjithshme për diskutim dhe nëse është e mundur për miratim.

2. Amendimet miratohen me shumicën e dy të tretave të shteteve palë të pranishme dhe votuese.

3. Amendimet për këtë Konventë, pasi janë miratuar, u paraqiten shteteve palë për ratifikim, pranim, miratim ose aderim.

4. Për shtetet palë që i kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose që kanë aderuar, amendimet e kësaj Konvente hyjnë në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të parashikuara në paragrafin 3 të këtij neni nga dy të tretat e shteteve palë. Në vijim, për çdo shtet palë që ratifikon, pranon, miraton një amendim ose aderim në të, ky amendim hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga shteti palë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

5. Procedura e vendosur në paragrafët 3 dhe 4 nuk zbatohet për amendimet e sjella në nenin 5 lidhur me numrin e shteteve anëtare të Komitetit. Këto amendime hyjnë në fuqi në çastin e miratimit të tyre.

6. Një shtet që bëhet palë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të amendimeve, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, në mungesë të shprehjes së një qëllimi ndryshe, shihet sikur është:

- a) palë në këtë Konventë të amenduar kështu dhe
- b) palë në këtë Konventë të paamenduar për çdo shtet palë që nuk është i lidhur nga këto amendime.

Neni 39

Tekste të besueshme

Kjo Konventë është hartuar në gjuhën angleze, arabe, kineze, spanjolle, frënge dhe ruse, të gjashtë tekstet njësoj autentike.

Neni 40

Regjistrimi

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet në Sekretariatit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

Bërë në Paris, më 3.11.2003, në dy kopje autentike, që mbajnë firmën e Presidentit të sesionit të 32-të të konferencës së përgjithshme dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s. Këto dy kopje do të depozitohen në arkivat e UNESCO-s. Kopje të vërtetuara do t'u jepen të gjitha shteteve të parashikuara në nenet 32 dhe 33, si dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

L I G J

Nr. 9491, datë 13.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARISË PRIVATE TË PAVARUR DHE PRIVATIZIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 25 i ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Ministria e Financave është i vetmi organ, që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.”.

Neni 2

Agjencia Kombëtare e Privatizimit shkrihet dhe pushon së funksionuari si institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4819, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr. 9493, datë 13.3.2006

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR
FINANCIMIN E PROGRAMIT “PËR PESË POLIKLINIKA NË QYTETET E TIRANËS,
GJIROKASTRËS, KORÇËS DHE PESHKOPISË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë””, me një kredi të butë prej 5 080 000 eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4821, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE FINANCIARE
MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ARTIGIANCASSA S.P.A.
EURO 5.080.000,00
PROGRAMI PËR PESË POLIKLINIKAT NË QYTETET E TIRANËS,
GJIROKASTRËS, KORÇËS DHE PESHKOPISË

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu dhe më tej, duke iu referuar si “Huamarrësi”), i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në njërën anë, dhe
 - Artigiancassa S.P.A., e listuar në Regjistrin e Bankave, me kapital aksionar prej 35 000 000,00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, me kod fiksial nr. 01158450583, TVSH nr. 00968081000 (këtu dhe më tej duke iu referuar si “Artigiancassa”), si administratori i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi, i krijuar sipas nenit 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977 në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Italisë dhe, më tej duke iu referuar atij në nenin 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987 përfaqësuar nga z.Carlo Larcinese, në anën tjetër,
- (Artigiancassa dhe Huamarrësi, së bashku, këtu dhe më tej, duke iu referuar si “Palët”), kanë vendosur të hyjnë në këtë Marrëveshje financiare.

Neni 1
Përkufizime

- Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, termat në vazhdim do të kenë kuptimet si vijojnë:
- “Njohja e të qenit në borxh”: do të thotë deklarimi, të cilit i bëhet referencë sipas nenit 10, me të cilin Huamarrësi merr përsipër, në favor të Artigiancassa, të rimburojë njëkohësisht kapitalin së bashku me interesin, të cilët janë detyrim sipas Kredisë së Butë;
 - “Banka Agjente”: do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), i cili do të jetë i përfshirë në aktivitetet që vijojnë:
 - verifikim i dokumentacionit kontraktual;
 - veprime disbursimi;
 - veprime pagesash.
 - “Marrëveshje”: do të thotë Marrëveshja financiare në fjalë, pjesa hyrëse dhe shtojcat e saj, të cilat janë pjesë integrale të vetë asaj;
 - “Banka shqiptare”: do të thotë banka vendase e emëruar nga Huamarrësi, si bankë korrespondente e Artigiancassa, e cila vepron si Bankë Agjente për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
 - “Dokumentacioni kontraktual”: do të thotë dokumentacioni të cilit i bëhet referencë në kontratën/at e furnizimit (p.sh. faturat, fleta e ngarkesës, lista e paketimit, situacione punimesh etj.);
 - “Periudha e faljes”: do të thotë periudha që zgjat 204 muaj, që fillon nga data e disbursimit të parë;
 - “Autoritetet kompetente italiane”: do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë ent tjetër kompetent i Republikës së Italisë, i emëruar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
 - “MPJ/DPBZH”: do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimi;
 - “Programi”: do të thotë projekti i lidhur me: “Programi për pesë poliklinikat në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, në rrjedhim të Marrëveshjes Qeveritare, pjesërisht e financuar me mjete nga Kredia e Butë;

- “Njësia e zbatimit të projektit(NJZP)”: do të thotë njësia teknike e krijuar pranë Ministrisë shqiptare të Shëndetësisë, e cila do të ofrojë koordinimin e funksioneve teknike dhe menaxheriale, të nevojshme për realizimin e programit;

- “Kredi e Butë”: do të thotë financimi, të cilin Artigiancassa do të japë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në nenin 1 dhe në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe mbi propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme;

- “Kontrata(t) e furnizimit”: do të thotë kontrata(at) tregtare që kanë të bëjnë me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italianë tek importuesit shqiptarë, të lidhura me realizimin e programit.

Neni 2

Pjesa hyrëse

2.1 Përmes marrëveshjes së njohur si “Marrëveshje Qeveritare” (këtu dhe më tej duke iu referuar si “Marrëveshja Qeveritare”) e nënshkruar më 17 maj 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, kjo e fundit është angazhuar ta financojë programin përmes një kredie të butë deri në një shumë maksimale prej 5 080 000,00 (pesë milionë e tetëdhjetë mijë) euro;

2.2 Përmes kësaj Marrëveshjeje, palët kanë ndërmend të: (i) zbatojnë parashikimet financiare, lidhur me Kredinë e Butë, të caktuara më parë në Marrëveshjen Qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë, bazuar në propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr. 79144, datë 18 korrik 2005 ka autorizuar Artigiancassa t’i japë Huamarrësit një kredi të butë, sipas termave dhe kushteve të caktuara më parë në nenin 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (këtu dhe më tej duke iu referuar si “Kredia e Butë”) për qëllimin e financimit të programit.

2.4 Artigiancassa, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të veprojë gjithashtu si Bankë Agjente dhe Banka Amerikane e Shqipërisë do të jetë Banka Shqiptare.

Neni 3

Kredia e Butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi, me këtë, pranon Kredinë e Butë, sipas kushteve që vijojnë :

- Shuma: deri në një maksimum prej 5 080 000,00(pesë milionë e tetëdhjetë mijë) euro;

- Kohëzgjatja: 38 vjet;

- Ripagimi: me 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuajor, të principalit, i pari i të cilëve kthehet në detyrim për t’u paguar 210 (dyqind e dhjetë) muaj nga data e disbursimit të parë;

- Norma e interesit: nominale, vjetore, 0.10% (zero pikë dhjetë për qind), e pagueshme në fund të çdo periudhe 6 (gjashtë) mujore nga data e secilës tërheqje;

- Qëllimi i kredisë: “Programi për pesë poliklinikat në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”.

3.2 Kredia e Butë do të përdoret për përfitimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimumi sa 30% (tridhjetë për qind) e shumës së lidhur me Kredinë e Butë, mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe importet të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim.

Në mënyrë të veçantë, secila kontratë që lidhet me kostot lokale dhe importet e mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim do të negociohet nëpërmjet, dhe do të nënshkruhet vetëm nga kontraktori/eksportuesi italian kryesor.

Kontratat e furnizimit do të jenë të përcaktuara në euro.

3.3 Kredia e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:
taksat lokale, detyrimet doganore, TVSH-në.

3.4 Kontratat e furnizimit, të lidhura me programin sipas nenit 2.1, do të prokurohen përmes tenderave publikë të rezervuar për shoqëritë italiane mbi bazën e procedurave të parashikuara për këtë në “Manualin e Procedurave”(i përafuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) lidhur me shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i KE-së në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e treta.

3.5 Kredia e Butë do të jetë e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara më parë në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, sapo Artigiancassa të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme, përmes Ambasadës Italiane- L’Ambasciata / UTL:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, i cili provon autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar, në emër dhe për llogari të Qeverisë shqiptare, këtë Marrëveshje nga një person plotësisht i autorizuar, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin prej kësaj Marrëveshjeje;

ii) Caktimin, me shkrim, nga autoriteti kompetent i Huamarrësit, të personit/ave plotësisht të autorizuar për ta nënshkruar këtë Marrëveshje (e certifikuar nga Ambasada Italiane në Tiranë – L’Ambasciata / UTL), kërkesen për financim të kontratave të furnizimit sipas formularit në shtojcën A dhe “Njohjen e të qenit në borxh” sipas formularit në shtojcën C së cilës i bëhet referencë sipas nenit 10 më poshtë. Ky caktim do të specifikojë emrin dhe pozitën e personit/ave dhe do të përmbajë të përditësuar depozitim të nënshkrimeve të tyre.

Çdo modifikim ndaj saj (nëse do të ketë) do të transmetohet në kohë nga Huamarrësi te Artigiancassa.

4.2 Artigiancassa do të njoftojë Huamarrësin dhe Bankën Shqiptare, me letër ose me faks, për datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive, sapo të ketë marrë, dhe në mënyrë plotësisht të kënaqshme, dokumentacionin e lartpërmendur, e cila do të ndiqet prej një konfirmimi me letër.

Neni 5

Termet për disbursimin e Kredisë së Butë

5.1 Periudha e disbursimit të Kredisë së Butë është 36 (tridhjetë e gjashtë)muaj nga data e disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të zgjatet nga ana e Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund ta zgjasë periudhën e disbursimit, në rast se Huamarrësi ose Autoritetet Kompetente Italiane nuk bien dakord për një zgjatje të tillë dhe kanë njoftuar me shkrim për Artigiancassa, të paktën 30 (tridhjetë)ditë kalendarike para skadimit të periudhës së disbursimit.

5.2 Në rastin kur periudha e disbursimit ka skaduar dhe është e pazgjatshme, Artigiancassa, pasi ta ketë konsultuar këtë me Autoritetet Kompetente Italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa, për sa u takon fondeve të papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe mënyrat për disbursimin e Kredisë së Butë

6.1 Kredia e Butë mund të përdoret nga Huamarrësi me përmbushjen e kushteve që vijojnë:

i) autorizimi i dhënë prej Autoriteteve Kompetente Italiane, për shpërndarjen e kontratës/ave në Kredinë e Butë;

ii) rezultat pozitiv nga verifikimi i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2(1) më poshtë;
iii) marrja nga ana e Artigiancassa e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit të parashikuar sipas nenit 7.1 si më poshtë.

6.2 Me marrjen prej Artigiancassa të autorizimit të përmendur në nenin 6.1(i) si më sipër, Artigiancassa do të veprojë menjëherë si më poshtë:

i) për të kryer kontroll, sipas kërkesave të parashikuara për këtë qëllim prej Autoriteteve Kompetente Italiane mbi eksportuesit italianë dhe mbi individët/shoqëritë, nëse ka, të përfshira me organizata vendase dhe mbi kontratën/at e furnizimit. Referuar kontratës/ave të furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë nëse ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e Kredisë së Butë dhe nëse janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme lidhur me kostot/çmimet, me qëllim që të lejojnë verifikimet e parashikuara në nenin 8.3;

ii) për të njoftuar Huamarrësin dhe Bankën Shqiptare për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1(i) si më sipër dhe t'i kërkojë Bankës Shqiptare, të paraqesë kërkesen, sipas parashikimit të bërë në nenin 7.1.

6.3 Rezultati pozitiv nga verifikimi i bërë nga Artigiancassa, siç parashikohet nga neni 6.2 (i) më sipër, do të çojë në akordimin e kontratës/ave të furnizimit në Kredinë e Butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të kryhet vetëm pas plotësimit të kushtit të caktuar më parë te neni 6.1(iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me letër/faks Huamarrësin, Bankën Shqiptare, NJZP dhe eksportuesin italian, për akordimin si edhe për financimin e kontratës/ave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultateve pozitive të dala nga verifikimi sipas nenit 6.2(i), Huamarrësi do të transmetojë tek Artigiancassa një letërkërkese për financimin e kontratës së furnizimit, e nevojshme për të kryer pagesat, e parashikuar kjo në çdo kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkesë, e cila do të jetë sipas formularit në shtojcën A, Huamarrësi njuh atë që kontrata/at e furnizimit është/janë e/të kualifikuar/a për t'u financuar dhe do të marrë përsipër të rimbursojë Artigiancassa për shumën e disbursuar.

7.2 Letra e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit, e parashikuar në nenin 7.1, do të merret në një kohë të shpejtë dhe në asnjë rast më vonë se 6(gjashtë) muaj nga data e njoftuar nga Artigiancassa parashikuar sipas nenit 6.4 më sipër ose në kohën(nëse ekziston) e parashikuar për të në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur, Artigiancassa, pas konsultimit me Autoritetet Kompetente Italiane, do të marrë në konsideratë anulimin e mundshëm të kontratës/ave tregtare të akorduara në kuadrin e Kredisë së Butë.

Neni 8

Disbursimet

8.1 Kërkesa për financimin e secilës kontratë furnizimi, parashikuar në nenin 7, do të kryhet nga lidhja e Bankës Shqiptare me çdo pagesë për t'u kryer, në përputhje me kushtet e parashikuara për këtë në kontratën e furnizimit, me paraqitjen e dokumentacionit kontraktual.

8.2 Eksportuesi italian do të lëvrojë dokumentacionin kontraktual dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në përputhje me kontratën e furnizimit, sipas formularit në shtojcën B. Një kopje origjinale e dokumentacionit kontraktual do të dërgohet në të njëjtën kohë nga Artigiancassa te Banka shqiptare dhe te NJZP.

8.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e dërgimit nga Artigiancassa të dokumentacionit kontraktual të sipërpërmendur, NJZP do të njoftojë me një komunikim me shkrim Artigiancassa dhe për dijeni një kopje Bankës Shqiptare, për përputhshmërinë me dokumentacionin kontraktual përkatës të mallrave dhe/ose shërbimeve të furnizuara.

8.4 Në vijim të marrjes së çdo kërkesë për disbursim, Artigiancassa do të ekzaminojë dokumentacionin kontraktual. Një ekzaminim i tillë do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën e furnizimit në fjalë.

8.5 Artigiancassa, pas rezultatit pozitiv nga verifikimi i parashikuar sipas nenit 8.3 dhe rezultatit pozitiv nga ekzaminimi i parashikuar sipas nenit 8.4, do të disbursojë shumën në fjalë në llogarinë brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së çdo kërkesë për disbursim dhe do të konfirmojë me teleks ose me faks në Bankën Shqiptare dhe në Ministrinë e Financave, shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën fondet i janë kredituar eksportuesit/ve italian/ë.

8.6 Artigiancassa do të kryejë pagesat në favor të eksportuesit/ve italian/ë dhe do të marrë prej këtyre eksportues/ve, vërtetimin për faturën e paguar të detyrimit, e parashikuar në shtojcën D në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i dërgohet Bankës Shqiptare.

8.7 Duke ndjekur çdo pagesë në favor të eksportuesit/ve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare një grafik të përditësuar të ripagimit, i cili tregon të gjitha shumat e disbursuara deri atëherë duke përfshirë dhe disbursimin e fundit, duke shënuar datat detyrim për pagesë që lidhen me to në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pëlqimin e tij për grafikun e ripagimit të lartpërmendur.

Neni 9

Ripagimi i Kredisë së Butë dhe pagesa e interesit

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të ripaguhet sipas grafikut të ripagimit në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmuajor (këtu dhe më tej duke iu referuar si “Këste të Principalit”), i pari nga të cilët bëhet detyrim për t'u paguar 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare, grafikun e ripagimit, në përputhje me nenin 8.7.

9.2 Mbi këstet e principalit të mbetura pa ripaguar dhe efektivisht të kredituara, interesi i mbetur do të përllogaritet sipas një norme nominale vjetore prej 0.1 % (zero pikë një për qind), të barasvlefshme me 0.05% (zero pikë zero pesë për qind) gjysmëvjetore, nga data në të cilën janë kredituar fondet deri në datën e ripagimit të këstit të fundit të principalit. Interesi do të përllogaritet bazuar në numrin e ditëve efektivisht të kaluara duke marrë për bazë një muaj me tridhjetë ditë dhe një vit me treqind e gjashtëdhjetë ditë (30/360).

9.3 Gjatë periudhës së ripagimit, interesi do të paguhet në të njëjtat data detyrim për pagesë të kësteve të principalit. Gjatë periudhës “Grace”, interesi do të paguhet çdo 6 (gjashtë) muaj në datat të cilat korrespondojnë si ditë dhe si muaj me datat e ripagimit të kësteve të principalit. Kësti i parë i pagesës së interesit mund të jetë i lidhur me një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj. Sidoqoftë, nëse kjo periudhë do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, kësti i interesit i cili i korrespondon asaj, do të paguhet së bashku me këstin ndjekës të interesit. Kësti i parë i interesit, i lidhur me një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj ose më pak se gjashtë muaj, do të përllogaritet mbi bazën e ditëve faktike që kalojnë ndërmjet datave të pagesës së tij duke marrë për bazë një periudhë gjashtëmuajore me 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike.

9.4 Pagesa e interesit të lidhur me çdo disbursim do të kryhet në datat kur ai është detyrim, të treguara këto në grafikun e ripagimit, të përcaktuara më parë në nenin 8.7, deri në datën e lëshimit të “Njohjes së të qenit në borxh” e referuar kjo në nenin 10 më poshtë; për periudhën në vijim ripagimi i principalit dhe pagesa e interesit do të kryhet në datat detyrim të treguara në grafikun e ripagimit, bashkëlidhur “Njohjes së të qenit në borxh”, të lartpërmendur.

9.5 Banka Shqiptare, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, merr përsipër të kryejë pa vonesë të gjitha pagesat dhe ripagimin detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe sipas “Njohjes së të qenit në borxh”, në datën aktuale të detyrimit, për shumën korresponduese në euro në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të përcaktuar për këtë. Këto shuma do të kreditohen pa asnjë zbritje të ndonjë komisioni bankar dhe/ose valutor dhe fiskal dhe pa qenë nevoja për njoftim për këtë nga Artigiancassa, ose prej të personave të caktuar të cilëve iu është kërkuar.

Neni 10

Lëshimi i “Njohjes së të qenit në borxh”

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të Kredise së Butë i caktuar më parë në nenin 5.1, Huamarrësi do të lëshojë për Artigiancassa, “Njohjen e të qenit në borxh”, të nënshkruar rregullisht dhe të sigluar në çdo faqe, sipas formularit në shtojcën C.

10.2 Grafiku i ripagimit, i përcaktuar më parë në “Njohjen e të qenit në borxh”, do të kompletohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit dhe të interesit të pamaturuara ende, dhe këstet që janë maturuar, por nuk janë paguar ende në datën e lëshimit të “Njohjes së të qenit në borxh”, e parashikuar në grafikun përkatës të ripagimit për çdo disbursim, në përputhje me parashikimet e nenit 8.7.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë “Njohjen e të qenit në borxh”, për arkivim dhe administrim, dhe kohë pas kohe do të evidentojë në “Njohjen e të qenit në borxh” çdo ripagesë të principalit dhe të interesit së bashku me këste që mund të jenë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo, të gjitha pagesat e parashikuara në “Njohjen e të qenit në borxh” të jenë kryer, Artigiancassa do t'i kthejë Huamarrësit, të firmosur rregullisht “Njohjen e të qenit në borxh”, si provë e kryerjes së ripagimit.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit, për të paguar shumat detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas “Njohjes së të qenit në borxh” lidhur me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm.

Neni 12

Rreziqet dhe forca madhore

12.1 Në rast të rreziqeve ndaj zbatimit të programit për shkak të forcave madhore (të tilla, si: lufta, përmbytjet, zjarri, tërmeti, konflikte pune dhe greva, veprime të qeverisë, vështirësive të papritura të transportit, punës dhe shkaqe të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuar në Marrëveshjen Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoriteteve Kompetente Italiane në lidhje me veprimtaritë e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të Kredisë së Butë, Artigiancassa ruan të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për disbursim sipas nenit 8, në rastin e ndonjë dështimi për të vepruar kundrejt Artigiancassa, sipas kësaj Marrëveshjeje apo kreditesh të tjera financiare të dhëna nga Qeveria e Republikës së Italisë për Qeverinë ose për Bankën Qendrore ose për Agjenci Shtetërore të Republikës së Shqipërisë në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, me ndryshimet e pësuara. Artigiancassa do të informojë, rast pas rasti, Huamarrësin dhe Bankën Shqiptare për një pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim siç është parashikuar në nenin 8, në rast se shumat korresponduese janë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane. Artigiancassa nuk do të quhet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit në rast se shumat për t'u disbursuar në kuadrin e Kredisë së Butë, nuk do të jenë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Neni 14
Interesvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arsye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa, mbi shumën e përmendur, interesvonesa, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përlllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 0,1% (zero presje një për qind) për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike, menjëherë vijuese, nga data origjinale e detyrimit, dhe më pas, me një normë prej 2,6% (dy presje gjashtë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa. Ky i dyti do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane; një përditësim i tillë do të ndodhë nga 1 janari 2007.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma Reference e Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë në fuqi në të tashmen apo në të ardhmen, që mund të jetë e detyrueshme për pagesë në Shqipëri, për ndonjë arsye çfarëdo, lidhur me këtë Marrëveshje dhe me "Njohjen e të qenit në borxh", do të përballohet, ekskluzivisht, nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë detyrim për t'u paguar në Itali, lidhur me këtë Marrëveshje, nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaron se do të përfitojë nga statusi fiskal, i parashikuar sipas nenit 19 të dekretit nr. 601 të 29 shtatorit 1973 të Presidentit të Republikës, me ndryshimet e pësuara.

Neni 16
Ligji i zbatueshëm

16.1 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet e interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët, këtu, do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind prej ose nga interpretimi dhe/ose realizimi i kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë (nëse është tentuar) ose ajo nuk përfundon me një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin prej ose lidhen me këtë Marrëveshje, do të zgjidhen, përfundimisht, sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi me tre arbitra:

- një arbitër i caktuar nga Huamarrësi;
- një arbitër i caktuar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë caktohet nga arbitrat e lartpërmendur ose, në rast të mosrënies dakord të tyre, prej kryetarit të Dhomës Tregtare Ndërkombëtare, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk caktojnë arbitrin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila do të vendosë sipas ligjit të Republikës së Italisë, do të jetë përfundimtar dhe pa kushte, i detyrueshëm për zbatim nga të dyja palët pa asnjë mundësi për ta apeluar.

17.6 Asnjë mosrënie dakord dhe asnjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të këtushme, nuk mundet ta pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat detyrim, të rëna dakord, për të gjitha shumatat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, veçanërisht, të gjitha shumatat e rezultuara nga grafikët e ripagimit të caktuara më parë në nenin 8 më sipër dhe nga “Njohja e të qenit në borxh” e lidhur me të.

Neni 18 **Komunikimet**

18.1 Njoftimet për t'u bërë, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të adresohen si vijon:
- MINISTRIA E FINANCAVE: BULEVARDI “DËSHMORËT E KOMBIT”, TIRANË, SHQIPËRI, Tel.: +355 -4- 250264 – Faks: +355 - 4- 228494
- BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË: RRUGA “ISMAIL QEMALI”, NR.27, TIRANË
Tel: + 355 4 276000, Faks: +355 4 24 87 62
- ARTIGIANCASSA S.P.A. VIA CRESCENZO DEL MONTE, ROMË, ITALI, BËRTHAMA OPERATIVE LEX N.49/1987 N.TELEFONI 0039-06-5845529-561-414 TELEFAKS N. 0039-06-5845466

Neni 19 **Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare**

19.1 Kjo Marrëveshje financiare hartohet në tre origjinale në anglisht.

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT)

Shtojca A

Nga : Banka Amerikane e Shqipërisë
Për : Artigiancassa S.p.a.

Marrëveshja financiare për..... (.....) euro, e nënshkruar nga, nëmëdhe nga Artigiancassa nëmë

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, do të donim t'ju informojmë se kontrata e furnizimit, këtu bashkëngjitur, nr..... datë..... midis dhe lidhur me (programin/projektin) është e kualifikuar për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej euro (.....), e cila i korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për(eksportuesi italian), që ju do të duhet të kryeni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne njohim faktin se pagesat që ju do të duhet të bëni në favor të eksportuesit italian, të treguara nga vetë ne, do të jenë subjekt i: (i) dorëzimit prej këtij eksportuesi të dokumenteve kontraktuale (si: faturat, fletëngarkesa, lista e paketimit, situacion i punimeve etj.); (ii) rezultatit pozitiv nga verifikimi i dokumenteve kontraktuale sipas nenit 8.3 dhe 8.5 të Marrëveshjes financiare ; (iii) dhe lëshimi i dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar në dy kopje origjinale.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumenteve kontraktuale, si dhe dy origjinale të dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar.

Me anë të kësaj, ne Ju konfirmojmë se Qeveria e merr përsipër, pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të ripaguaj, çdo shumë të kredituar nga Ju tek eksportuesit italianë, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga skadimi i afatit të fundit të disbursimit të Kredisë së Butë të caktuar më parë në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, ne marrim përsipër të lëshojmë një “Njohje të të qenit në borxh” për shumën principale, e cila korrespondon me shumën e të gjitha disbursimeve të bëra sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo “Njohje e të qenit në borxh” do të jetë sipas formularit në shtojcën C të Marrëveshjes financiare.

Juaji sinqerisht,

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

Shtojca B

Nga:(Eksportuesi italian)

Për : Artigiancassa S.p.a.

Marrëveshja financiare për..... (.... ...) euro, nënshkruar nga nëmëdhe nga Artigiancassa S.p.a., nëmë

Të nderuar zotërinj

Duke iu referuar kontratës së furnizimit, nr.datëmes nesh dhe(importues) për shumën prej (.... ...) eurosh lidhur me(programin /projektin), ne ju dërgojmë dokumentet kontraktuale që vijojnë:

.....
.....
.....
.....

Ne ju kërkojmë të disbursoni shumën e lartpërmendur brenda 45 ditëve nga dita e marrjes së kësaj kërkesë në llogarinë bankare që vijon (Banka e eksportuesit italian).

BBAN Çelur në emër tëBanka:nr.telefoni i zyrës së degës nr. Faks i zyrës së degës.....

Juaji sinqerisht,

Datë

Nënshkrimi

Ne, me këtë, konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit

.....

(Banka e eksportuesit italian)

FORMULARI I NJOHJES SË TË QENIT NË BORXH

Shtojca C

.....(Huamarrësi)

Nr.

Vendi dhe data e lëshimit:

.....

Referuar Marrëveshjes financiare ndërmjet(Huamarrësi), i cili vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë sëdhe Artigiancassa, e nënshkruar në mëdhe në më (Huamarrësi) nje marrjen e shumave që vijojnë nga Artigiancassa :

.....më

.....më.....

.....më

Për këtë,(Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj Artigiancassa, si administratore e Fondit Qarkullues për Bashkëpunim e Zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave(MEF) të Italisë - me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën principale prej (.... ...) eurosh, të cilën ai merr përsipër ta ripagujë në(....) këste të barabarta, gjashtëmujore, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar më dhe i fundit më , sipas grafikut të ripagimit, të caktuar më parë, këtu dhe më poshtë.

Në shumën e veçantë të principalit të kësaj “Njohjeje të të qenit në borxh”.....(Huamarrësi), merr përsipër të pagujë interesin të cilit i është bërë referencë në grafikun e ripagimit të caktuar më parë dhe këtu e më poshtë, i përlogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare

.....(Huamarrësi) do të ripagujë këstet e principalit dhe interesin e parashikuar në këtë “Njohje të të qenit në borxh”, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datën e detyrimit, rënë dakord, në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të....., të zhveshur nga çdo tarifë shërbimi e bankës dhe/ose këmbimi.

Nëse, zyra e degës në Romë e....., për ndonjë arsye çfarëdo, duke përfshirë edhe për arsye jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin dhe interesin, të parashikuara në “Njohjen e të qenit në borxh”, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i pagujë zyrës së degës në Romë të....., interesvonesë mbi këto shuma, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

Kjo interesvonesë do të përlogaritet me normën për periudhën e ditëve që vijojnë menjëherë nga data origjinale e detyrimit dhe më tej me normën deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa.

.....

(sigla e Huamarrësit)
vazhdon

Shtojca C vijon

Ky interes i fundit, i lidhur me dështimin për të vepruar, do të përditësohet nga autoritetet kompetente italiane.

Interesi për dështimin për të vepruar do të përlllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Zyra e degës në Romë edo të shënojë, kohë pas kohe, në këtë “Njohje të të qënit në borxh”, çdo pagesë të principalit dhe të interesit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e listuara në grafikun e ripagimit, i caktuar më parë dhe këtu e në vijim, kjo “Njohje e të qënit në borxh”, do t’i kthehet(Huamarrësi).

Kjo “Njohje e të qënit në borxh” është lëshuar në zbatim të Kredisë së Butë prej (.....) eurosh, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit, 1987.

GRAFIKU I RIPAGIMIT

Data e maturimit	Këste Principali	Këste Interesi	Shuma
a)
b)
c)
d)
1)
2)
3)
4)
5)
6)
7)
8)
9)
10)

.....
(Nënshkrimi i Huamarrësit)

(FORMULARI I VËRTETIMIT PËR FATURË TË PAGUAR)

Shtojca D

Nga: Eksportuesi italian
Për: Bankën Amerikane të Shqipërisë
Për: Artigiancassa S.p.a.

VËRTETIM PËR FATURË TË PAGUAR

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nrnënshkruar më mes shoqërisë sonë dhepër furnizimin e, ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi marrë shumën prej (.... ...) euro si pagesë e pjeshme/totale e kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë lidhet me Kredinë e Butë prej..... (.... ...) eurosh, të dhënë nga Artigiancassa, për Qeverinë e, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987, me ndryshimet e pësuara, me anë të Marrëveshjes financiare të nënshkruar në mëdhe nëmë.....

Ne, për këtë, me anë të kësaj, deklarojmë të jemi paguar tërësisht për shumën detyrim sipas Kredisë së Butë si pagesë për shumën prej eurosh dhe se Huamarrësi dhe Artigiancassa nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë e lidhura me shumën e marrë.

Nënshkrimi

.....

Ne, me këtë konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit

.....

Banka e eksportuesit italian

L I G J

Nr. 9494, datë 13.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8981, DATË 12.12.2002 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, paragrafi i dytë i nenit 1/1, si dhe shënimi i bërë në aneksin 1 të këtij ligji shfuqizohen.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4822, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu**

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) 1500**
-
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
 - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT 500**
- 2. KODI DOGANOR 1000**
- 3. KODI DETAR 1000**

U dorëzua për shtyp më 3.4.2006
Doli nga shtypi më 7.4.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë